



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.41

2005

13 qershor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.373, datë 31.5.2005	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.60, datë 21.2.1994 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie toke në përdorim 577 familjeve fshatare, banorë të ish-ndërmarrjes bujqësore, Ksamil”, të ndryshuar..... 1459
Vendim i KM nr.374, datë 31.5.2005	Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve..... 1459
Vendim i KM nr.375, datë 31.5.2005	Për rritjen e trajtimeve financiare, të veçanta..... 1460
Vendim i KM nr.376, datë 31.5.2005	Për disa shtesa në vendimin nr.88, datë 1.3.1993 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e zonave, që kanë përparësi zhvillimin e turizmit”, të ndryshuar..... 1461
Vendim i KM nr.377, datë 31.5.2005	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i kanaleve kulluese-vaditëse, të dëmtuara nga ndërtimi dhe rehabilitimi i segmentit rrugor Kakavijë-Gjirokastrë..... 1462
Vendim i KM nr.379, datë 31.5.2005	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, shtëpi banimi, e cila rrezikohet nga linja e tensionit të

	lartë 400 Kv, Elbasan-Kufi.....	1467
Vendim i KM nr.381, datë 31.5.2005	Për një shtesë në vendimin nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.....	1468
Vendim i KM nr.383, datë 31.5.2005	Për rritjen e pensioneve.....	1469
Vendim i KM nr.384, datë 31.5.2005	Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve.....	1470
Vendim i KM nr.385, datë 31.5.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	1471
Vendim i KM nr.386, datë 31.5.2005	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Orikum-Dhërmë.....	1472
Vendim i KM nr.388, datë 31.5.2005	Për përbërjen, funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Komisionit Shtetëror të Prodhimit Organik.....	1478
Vendim i KM nr.419, datë 9.6.2005	Për disa ndryshime në dokumentin “Rregullorja e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.839, datë 17.12.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.	1480
Udhëzim i KQZ nr.17, datë 6.6.2005	Për përcaktimin e rregullave për deklarimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore, të subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2005	1480
Udhëzim i KQZ nr.18, datë 10.6.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 5.4.2005 “Për detyrat e Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2005”.....	1485

VENDIM
Nr.373, datë 31.5.2005

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.60, DATË 21.2.1994 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DHËNIE TOKE NË PËRDORIM 577 FAMILJEVE FSHATARE, BANORË TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE, KSAMIL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 5 të ligjit nr.7501, datë 1.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.60, datë 21.2.1994 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi dhe shtesa:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Përfitojnë tokë sipas ligjit nr.7501, datë 1.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar, familjet fshatare, të ardhura në territorin e ish-ndërmarrjes bujqësore, Ksamil, pas datës 1.9.1991, të përfshira në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.185, datë 14.5.1994 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në vendimin nr.60, datë 21.2.1994 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie toke në përdorim 577 familjeve fshatare, banorë të ish-ndërmarrjes bujqësore, Ksamil””, dhe që janë regjistruar në gjendjen civile të komunës Ksamil, deri më datë 16.5.2005.”.

b) Pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Ngarkohet komisioni i tokës i komunës Ksamil, për hartimin e listave e familjeve fshatare, banorë të kësaj komune, sipas përcaktimit të pikës 1, dhe këshilli i kësaj komune për miratimin e këtyre listave.”.

2. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit dhe njësitë e qeverisjes vendore të komunës Ksamil për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.374, datë 31.5.2005

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijon:

Për vitin	2004	1
Për vitin	2003	1.1

Për vitin	2002	1.09
Për vitin	2001	1.14
Për vitin	2000	1.07
Për vitin	1999	1.09
Për vitin	1998	1.05
Për vitin	1997	1.22
Për vitin	1996	1.09
Për vitin	1995	1.37
Për vitin	1994	1.32

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, që janë vetëm për pensionet që përcaktohen në vitin 2005 e që fillojnë nga data 1.1.2005, të përballohen nga buxheti i po këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.357, datë 1.6.2004 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.375, datë 31.5.2005

PËR RRITJEN E TRAJTIMEVE FINANCIARE, TË VEÇANTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të nenit 5 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, të nenit 8 të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake” dhe të nenit 6/1 të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

2. Masat e trajtimeve të veçanta, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

3. Masat e trajtimeve të veçanta, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

4. Masat e trajtimeve të veçanta, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2005, llogariten në shumën 27 500 000 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë dhe të përballohen nga buxheti i po këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

6. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.376, datë 31.5.2005

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.88, DATË 1.3.1993 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E ZONAVE, QË KANË PËRPARËSI ZHVILLIMIN E
TURIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.88, datë 1.3.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

a) Në shkronjën “A”, në paragrafin “Territoret nga Pishë Poro në Zvërnec, ato kufizuese të gjirit të Vlorës”, shtohen fjalët “..., përjashtuar zonën e Akernisë.”.

b) Në shkronjën “B”, në paragrafin “Bregu i liqenit të Butrintit, në rrethin e Sarandës”, shtohen fjalët “..., përjashtuar zonën e Ultësirës së Vrinës dhe fushën e Vurgut.”.

2. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.377, datë 31.5.2005

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I KANALEVE
KULLUESE-VADITËSE, TË DËMTUARA NGA NDËRTIMI DHE REHABILITIMI I
SEGMENTIT RRUGOR KAKAVIJË-GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i kanaleve kulluese-vaditëse, të dëmtuara nga ndërtimi dhe rehabilitimi i

segmentit rrugor Kakavijë-Gjirokastrë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për një sipërfaqe të përgjithshme 43 922 m² tokë arë, me vlerë 43 922 000 (dyzet e tre milionë e nëntëqind e njëzet e dy mijë) lekë, kultura bujqësore, me vlerë 570 986 (pesëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë, me një vlerë të përgjithshme 44 492 986 (dyzet e katër milionë e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 588 240 (pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e dyzet) lekë.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 45 081 226 (dyzet e pesë milionë e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2005, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.6.2005.

7. Pronarët, e përcaktuar në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët nga zyra e regjistrimit është shënuar “Mungesë kartepronësie dhe pretendim pronësie”, do të marrin shpërblimin për efekt të shpronësimit, pasi të jenë pajisur me dokumentacionin e plotë ligjor nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Deri në atë çast paratë do të jenë të bllokuara në bankë.

8. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

REPUBLIKA SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU: GJIROKASTER

Lista e pronareve qe shpronsohen per shkak te ndertimit te kanaleve kultures - vadites te demtuar nga ndertimi i segmentit rruqor Kakavije-Gjirokafter

Lloji i pasurise : Toke are dhe kulture bujqesore (1- 114)

Nr.	Pronari		Fshati	Nr. i pasur. i	Sipert. per shpron.	Cmimi leke/m2	Vlera Leke	Kulture cmimi lek/m2	Vler. bujq.	Vlera totale ne leke	Shenime sqartuese
	Emri	Atesia Mbiemri									
1	Nikolla	Gaqi Duci	Bodrishte	74/1	375	1000	375000	13	4875	379875	konfirmim ZRPP
2	Athina	Grigor Duci		74/2	125	1000	125000	13	1625	126625	konfirmim ZRPP
3	Vangjel	Niko Nika		74/3	250	1000	250000	13	3250	253250	konfirmim ZRPP
4	Thoma	Gaqi Barka		16/103	1300	1000	1300000	13	16900	1316900	pretendim pronesie
5	Kosta	Gaqi Barka	Bularat	16/104	430	1000	430000	13	5590	435590	pretendim pronesie
6	Jorgo	Kosta Ljoli		16/105	300	1000	300000	13	3900	303900	pretendim pronesie
7	Gaqi	Kosta Barka		65/4	2090	1000	2090000	13	27170	2117170	munjon kartela e prones
8	Gaqi	Kosta Barka		67	450	1000	450000	13	5850	455850	munjon kartela e prones
9	Jani	Dhimiter Xholi	Zervat	62/1	603	1000	603000	13	7839	610839	munjon kartela e prones
10	Dhimiter	Jani Xholi		62/2	546	1000	546000	13	7098	553098	munjon kartela e prones
11	Vangjel	Dhimiter Barka		61/1	887	1000	887000	13	11531	898531	munjon kartela e prones
12	Kristo	Vangjel Barka		61/2	408	1000	408000	13	5304	413304	munjon kartela e prones
13	Mihai	Telemak Xhumba	Bularat	60/1	1410	1000	1410000	13	18330	1428330	munjon kartela e prones
14	Thoma	Jorgo Mastaka		26/2	650	1000	650000	13	8450	658450	munjon kartela e prones
15	Thanas	Jorgo Mastaka		26/1	827	1000	827000	13	10751	837751	munjon kartela e prones
16	Jani	Ilia Gjati		25/1	1312	1000	1312000	13	17056	1329056	munjon kartela e prones
17	Jani	Dhimiter Kacifa	Zervat	22/1	1400	1000	1400000	13	18200	1418200	konfirmim ZRPP
18	Rusa	Thoma Qiro		21/1	1290	1000	1290000	13	16770	1306770	munjon kartela e prones
19	Gjergj	Llambi Xulla		8/1	980	1000	980000	13	12740	992740	munjon kartela e prones
20	Thanas	Niko Kuremeno		7/1	1274	1000	1274000	13	16562	1290562	munjon kartela e prones
21	Dhimiter	Mandi Qiqi	Zervat	81/22	987	1000	987000	13	12831	999831	munjon kartela e prones
22	Jani	Kosta Kaliva		82/25	1040	1000	1040000	13	13520	1053520	munjon kartela e prones
23	Vasilqi	Razo Baxho		83/56	1140	1000	1140000	13	14820	1154820	munjon kartela e prones
24	Dhimiter	Thanas Rafi		84/28	1408	1000	1408000	13	18304	1426304	munjon kartela e prones

25	Dhimiter	Thanas	Rafti		86/29	1408	1000	1408000	13	18304	1426304	mungon kartela e prones
26	Llazo	Mihal	Agora		87/20	1316	1000	1316000	13	17108	1333108	mungon kartela e prones
27	Thoma	Vangjel	Xarxallo	Jergucat	61/45	1576	1000	1576000	13	20488	1596488	mungon kartela e prones
28	Ndrec	Prenek	Lieshi		60/28	1260	1000	1260000	13	16380	1276380	mungon kartela e prones
29	Jorgo	Ziko	Qiro		59/30	1350	1000	1350000	13	17550	1367550	mungon kartela e prones
30	Dhimiter	Llambi	Aleksi		45/40	120	1000	120000	13	1560	121560	konfirmim ZRPP
31	Llambi	Mihal	Dero		45/39	1220	1000	1220000	13	15860	1235860	konfirmim ZRPP
32	Mihal	Thoma	Xhupa		45/38	60	1000	60000	13	780	60780	konfirmim ZRPP
33	Jorgo	Dhimiter	Decka		43/31	1490	1000	1490000	13	19370	1509370	mungon kartela e prones
34	Shoqeria	Morpack	Albania SH A		43/41	211	1000	211000	13	2743	213743	Hip ALFA BANK A.E. Tirane
35	Theodhori	Sotir	Beci		42/25	818	1000	818000	13	10634	828634	konfirmim ZRPP
36	Kosta	Kristo	Lulo		42/24	420	1000	420000	13	5460	425460	mungon kartela e prones
37	Panajot	Kristo	Lulo		42/23	210	1000	210000	13	2730	212730	mungon kartela e prones
38	Vangjel	Kristo	Papaila		39/15	747	1000	747000	13	9711	756711	mungon kartela e prones
39	Aleks	Foto	Jovani		39/14	520	1000	520000	13	6760	526760	mungon kartela e prones
40	Stefo	Vangjel	Xarxallo		38/12	630	1000	630000	13	8190	638190	konfirmim ZRPP
41	Vangjel	Spiro	Xarxallo		38/10	510	1000	510000	13	6630	516630	mungon kartela e prones
42	Kosta	Filip	Qiro		35/10	1218	1000	1218000	13	15834	1233834	mungon kartela e prones
43	Theofan	Filip	Qiro		35/9	202	1000	202000	13	2626	204626	pretendon Vasil Andon Decka per 100m2
44	Vasil	Vangjel	Dhrapa	Vanister	48/1	244	1000	244000	13	3172	247172	konfirmim ZRPP
45	Vitori	Kristo	Kufo		48/2	94	1000	94000	13	1222	95222	konfirmim ZRPP
46	Aleksander		Kufo		48/3	94	1000	94000	13	1222	95222	mungon kartela e prones
47	Sofia	Kristo	Noti		48/4	88	1000	88000	13	1144	89144	konfirmim ZRPP
48	Andrea	Pandeli	Velo		48/5	280	1000	280000	13	3640	283640	konfirmim ZRPP
49	Kristaq		Fidhi		48/6	104	1000	104000	13	1352	105352	konfirmim ZRPP
50	Dhimiter	Timo	Gjini		48/7	200	1000	200000	13	2600	202600	konfirmim ZRPP
51	Vasil	Timo	Gjini		48/8	80	1000	80000	13	1040	81040	konfirmim ZRPP
52	Thimjo		Jovani	Goranxi	30/4	43	1000	43000	13	559	43559	mungon kartela e prones
53	Kristo		Kufo		30/5	57	1000	57000	13	741	57741	konfirmim ZRPP
54	Spiro	Jorgo	Qiqi		30/6	92	1000	92000	13	1196	93196	konfirmim ZRPP
55	Dhimiter	Vasil	Kaci		30/7	55	1000	55000	13	715	55715	konfirmim ZRPP
56	Vasil	Thodhori	Samaro		30/8	70	1000	70000	13	910	70910	konfirmim ZRPP
57	Vangjel	Ilia	Kukumi		30/9	70	1000	70000	13	910	70910	te kerkoheh rikonf.Z.R.P.P
58	Mihal	Panojot	Cam		30/10	80	1000	80000	13	1040	81040	
59	Mihal	Kosta	Bakiri		30/11	63	1000	63000	13	819	63819	mungon kartela e prones
60	Kristo	Thanas	Shamo		30/12	30	1000	30000	13	390	30390	
61	Thodhori	Jorgo	Cinga		48/7	1468	1000	1468000	13	19084	1487084	konfirmim ZRPP

62	Kristo	Jorgo	Gole	48/1	938	1000	938000	13	12194	950194	konfirmim ZRPP
63	Stavro	Jani	Qendro	5/8	135	1000	135000	13	1755	136755	konfirmim ZRPP
64	Mihal	Kosta	Qiqi	5/7	70	1000	70000	13	910	70910	konfirmim ZRPP
65	Emilio	Spiro	Joti	5/6	90	1000	90000	13	1170	91170	konfirmim ZRPP
66	Jorgjia	Thanas	Varsami	5/5	23	1000	23000	13	299	23299	konfirmim ZRPP
67	Thoma	Kristo	Qiqi	5/4	40	1000	40000	13	520	40520	konfirmim ZRPP
68	Jani	Jorgo	Qiqi	5/3	100	1000	100000	13	1300	101300	konfirmim ZRPP
69	Dhimiter	Kristo	Qiqi	5/2	154	1000	154000	13	2002	156002	munjon kartela e prones
70	Spiro	Theofan	Malo	5/1	189	1000	189000	13	2457	191457	konfirmim ZRPP
71	Vasil	Nikolla	Curri	159/41	50	1000	50000	13	650	50650	te kerkohe rikont.Z.Rr.P.P
72	Vasil	Mihal	Dede	159/37	50	1000	50000	13	650	50650	munjon kartela e prones
73	Ilia	Niko	Selo	159/33	44	1000	44000	13	572	44572	konfirmim ZRPP
74	Nikolla	Vasil	Lili	159/29	30	1000	30000	13	390	30390	konfirmim ZRPP
75	Andromaqi	Zoi	Lezo	159/25	40	1000	40000	13	520	40520	konfirmim ZRPP
76	Foto	Sokrat	Selo	159/21	38	1000	38000	13	494	38494	konfirmim ZRPP
77	Vangjel	Niko	Goga	159/17	20	1000	20000	13	260	20260	konfirmim ZRPP
78	Spiro	Andrea	Dako	159/13	30	1000	30000	13	390	30390	pretendim
79	Dhimiter	Spiro	Cami	159/9	30	1000	30000	13	390	30390	konfirmim ZRPP
80	Theodhori	Theodhori	Curi	159/5	36	1000	36000	13	468	36468	konfirmim ZRPP
81	Kristo	Vasil	Baruta	159/1	46	1000	46000	13	598	46598	konfirmim ZRPP
82	Kristo	Andon	Dede	59/4	40	1000	40000	13	520	40520	konfirmim ZRPP
83	Figalia	Vaso	Dhjamandi	59/5	30	1000	30000	13	390	30390	te kerkohe rikont.Z.Rr.P.P
84	Vasil	Spiro	Guxo	59/9	30	1000	30000	13	390	30390	konfirmim ZRPP
85	Aristotel	Vasil	Maliqi	59/14	40	1000	40000	13	520	40520	munjon kartela e prones
86	Spiro	Pando	Maluqi	59/19	40	1000	40000	13	520	40520	konfirmim ZRPP
87	Vasil	Kosta	Basho	59/23	70	1000	70000	13	910	70910	konfirmim ZRPP
88	Jani	Pando	Maluqi	59/27	100	1000	100000	13	1300	101300	konfirmim ZRPP
89	Kosta	Spiro	Curi	59/31	100	1000	100000	13	1300	101300	konfirmim ZRPP
90	Thoma	Thodhori	Niho	59/47	100	1000	100000	13	1300	101300	konfirmim ZRPP
91	Petro	Jani	Mastora	59/51	100	1000	100000	13	1300	101300	konfirmim ZRPP
92	Jani	Thanas	Dako	59/55	60	1000	60000	13	780	60780	konfirmim ZRPP
93	Vasil	Mantho	Maluqi	59/59	30	1000	30000	13	390	30390	konfirmim ZRPP
94	Qirjako	Thanas	Lico	59/63	30	1000	30000	13	390	30390	konfirmim ZRPP
95	Irakli	Foto	Baruta	59/67	28	1000	28000	13	364	28364	konfirmim ZRPP
96	Thimjo	Kristo	Laci	59/71	20	1000	20000	13	260	20260	konfirmim ZRPP
97	Mihal	Kristo	Sirmo	59/75	20	1000	20000	13	260	20260	konfirmim ZRPP
98	Mantho	Niko	Dako	59/79	30	1000	30000	13	390	30390	konfirmim ZRPP

99	Kristo	Sotir	Dhuka	59/83	40	1000	40000	13	520	40520	konfirmim ZRPP
100	Amalia	Mihal	Curi	59/87	20	1000	20000	13	260	20260	konfirmim ZRPP
101	Thanas	Kosta	Draguta	59/88	20	1000	20000	13	260	20260	konfirmim ZRPP
102	Foto	Kosta	Kotra	59/92	50	1000	50000	13	650	50650	konfirmim ZRPP
103	Eleni		Stamuli	59/96	48	1000	48000	13	624	48624	konfirmim ZRPP
104	Jani	Spiro	Zhaka	59/100	50	1000	50000	13	650	50650	mungon kartela e prones
105	Jani	Mihal	Beqari	59/104	56	1000	56000	13	728	56728	konfirmim ZRPP
106	Ilia	Foto	Karaxha	59/108	60	1000	60000	13	780	60780	konfirmim ZRPP
107	Foto	Thodhori	Guxo	59/112	70	1000	70000	13	910	70910	konfirmim ZRPP
108	Foto	Kristo	Guxo	59/116	100	1000	100000	13	1300	101300	konfirmim ZRPP
109	Mihal	Spiro	Qiro	59/120	100	1000	100000	13	1300	101300	konfirmim ZRPP
110	Amalia	Jani	Paco	59/124	60	1000	60000	13	780	60780	konfirmim ZRPP
111	Sokrat	Panajot	Paco	59/127	56	1000	56000	13	728	56728	konfirmim ZRPP
112	Thodhori	Jorgo	Niko	59/128	50	1000	50000	13	650	50650	konfirmim ZRPP
113	Thoma	Mihal	Grexo	59/129	81	1000	81000	13	1053	82053	konfirmim ZRPP
114	Irakli	Jorgo	Sirmo	59/130	60	1000	60000	13	780	60780	konfirmim ZRPP
SHUMA				43922	43922	43922000	570986	44492986			

Mbyllet me numer rendor 114 (njeqindekatembdhjete)

Shpenzime proceduriale leke 588 240
Vlera totale e shpronesimit leke 45 081 226

VENDIM

Nr.379, datë 31.5.2005

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, SHTËPI BANIMI, E CILA RREZIKOHET NGA LINJA E TENSIONIT TË
LARTË 400 KV, ELBASAN-KUFI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 8, shkronja “ë”, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, shtëpi banimi, e cila rrezikohet nga linja e tensionit të lartë 400 kV, Elbasan-Kufi, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH sh.a.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 1 440 000 (një milion e katërqind e dyzet mijë) lekësh, për shtëpinë e banimit me sipërfaqe 96 m².

4. Shpenzimet procedurale për realizimin e shpronësimit janë në shumën 103 000 (njëqind e tre mijë) lekë.

5. Fondi prej 1 440 000 (një milion e katërqind e dyzet mijë) lekësh, për shpronësimin e pronarit, dhe fondi prej 103 000 (njëqind e tre mijë) lekësh, për shpenzimet procedurale, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, zëri “Kosto lokale për shpronësimet” i KESH sh.a.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit qershor 2005.

7. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Librazhd, të kryejë çregjistrimin e shtëpisë, brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, KESH sh.a. dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Librazhd, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Republika e Shqipërisë
Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës

SË TYRE BRENDË ZONËS MBROJTËSE TË LINJËS TË TENSIONIT TË LARTË 400 KV
ELBASAN-KUFI

Rrethi: Librazh

Fshati: Vulçan

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: shtëpi banimi

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë që shpronësohet	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sasia në m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	Adresa
1	Reshit	Arif	Stafa	Shtëpi banimi	3843	407/1	96	15 000	1 440 000	Vulçan-Librazhd
Totali									1 440 000	

Sqarime: Shpezimet procedurale:

1. Publikime, 78 000 (shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë.

2. Shpërblim i anëtarëve të komisionit, 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

Vlefë totale e shpronësimit=1 440 000+103 000=1 543 000 lekë.

VENDIM

Nr.381, datë 31.5.2005

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.424, DATË 9.7.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE QË
KRIJOJNË INSTITUCIONET BUXHETORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “b” të pikës 1 të vendimit nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Të ardhurat me pjesëmarrje, të realizuara nga Agjencia Telegrafike Shqiptare, nga shitja e lajmeve me kompjuter+modem, si dhe nga shërbimi fotografik, t’i mbeten këtij institucioni, në masën 90 për qind, ndërsa 10 për qind të derdhen në Buxhetin e Shtetit.”.

2. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Agjencia Telegrafike Shqiptare për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët, për përdorimin e këtyre të ardhurave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.383, datë 31.5.2005

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr.7663, datë

20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme të pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, pensionet për merita të veçanta, pensionet e posaçme shtetërore, shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, të rriten në masën 8 për qind.

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të rriten në masën 15 për qind.

3. Rritje pensioni përfitojnë:

a) në masën 8 për qind edhe pensionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.6.2005, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë;

b) në masën 15 për qind edhe pensionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.6.2005, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë.

4. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, që caktohen sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar pensionet, që caktohen sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të këtij ligji, me datë fillimi nga 1.6.2005 e në vazhdim, të caktohen jo më pak se 7 850 (shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj dhe jo më shumë se 15 700 (pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj.

5. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, që caktohen sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.6.2005 e në vazhdim, të caktohen jo më pak se 3430 (tre mijë e katërqind e tridhjetë) lekë në muaj.

6. Rritja e pensioneve, e parashikuar nga ky vendim, të zbatohet edhe për shtesat mbi pension, të dhëna sipas neneve 33, 38 e 39 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

7. Shtesa mujore, e përfituar sipas ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të rritet në masën 8 për qind.

8. Pensionet e caktuara me dekretin e Presidentit nr.758, datë 1.2.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”, miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994 të rriten në masën 8 për qind.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2005, në shumën 1 968.2 milionë lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

10. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.384, datë 31.5.2005

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të ushtarakëve, që për shkak të detyrës, bëhen të paaftë plotësisht, pensionet suplementare familjare dhe pensionet suplementare të familjeve të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2005, llogariten në shumën 65 500 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e pesëqind mijë) lekë dhe të përballohen nga buxheti i po këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM **Nr.385, datë 31.5.2005**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.402, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE TË LIGJIT NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Në kapitullin II “Shuma bazë e përfitimeve”, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36 dhe 48, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit, nga data 1.6.2005 e në vazhdim, të jetë 7850 (shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për personat që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit, të përcaktuar nga paragrafi i parë i këtij neni, shuma bazë e përfitimit, nga data 1.6.2005 e në vazhdim, të jetë 3430 (tre mijë e katërqind e tridhjetë) lekë në muaj.

Në zbatim të pikës 4 të nenit 27 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit është 3430 (tre mijë e katërqind e tridhjetë) lekë në muaj.”.

2. Në kapitullin III “Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve”, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën 1.6.2005 e në vazhdim, të jetë 5243 (pesë mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë.

Kontributi minimal mujor, sipas degëve të sigurimit, të jetë:

	Në lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	100;
Dega e sigurimit të barrë-lindjeve	288;
Dega e sigurimit të pensioneve	3742;
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe e sëmundjeve profesionale	63;
Dega e sigurimit të papunësisë	625;
Sigurimet shëndetësore	425.”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Punëdhënësi derdh kontribute të detyrueshme në masën 41.9 për qind të pagës mujore, sipas listëpagesave. Nga data 1.6.2005 e në vazhdim, paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të jetë 12 514 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e katërbëdhjetë) lekë, ndërsa paga maksimale të jetë 62 570 (gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë.”.

c) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Punëdhënësi privat, i vetëpunësuarit, të vetëpunësuarit në ortakëri, që ushtrojnë veprimtari ekonomike, me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi, duke filluar nga 1.6.2005 e në vazhdim, të derdhin kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në masën 39.2 për qind të pagës mujore minimale prej 12 514 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e katërbëdhjetë) lekësh.”.

ç) Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Pjesëtarët e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me punëdhënësin privat dhe të vetëpunësuarin, me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi duke filluar nga data 1.6.2005 e në vazhdim, të derdhin kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në masën 39.2 për qind të pagës mujore minimale prej 12 514 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e katërbëdhjetë) lekësh.”.

d) Në pikën 5, shifra “11376” zëvendësohet me “12 514”.

dh) Në pikën 6, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë vijon:

“Të vetëpunësuarit në bujqësi mund t'i paguajnë kontributet e detyrueshme për sigurimet shëndetësore, pavarësisht nga pagesa e kontributeve për sigurimin shoqëror.

Paga minimale bazë, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shëndetësore për të vetëpunësuarit në bujqësi, është 4500 (katër mijë e pesëqind) lekë në muaj.

Masa e kontributit është 5 për qind e pagës minimale mujore në zonat fushore, ndërsa në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë e Tropojë masa e kontributit është 3 për qind e pagës minimale mujore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.386, datë 31.5.2005

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ORIKUM-DHËRMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Orikum-Dhërm.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për një sipërfaqe të përgjithshme 24 409 m² tokë arë, me vlerë 14 645 400 (katërmëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e pesë mijë e katërqind) lekë, 571 copë dru frutorë, me vlerë 1 237 900 (një milion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind) lekë, me vlerë të përgjithshme 15 883 300 (pesëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind) lekë.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 686 520 (gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet) lekë.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 16 569 820 (gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2005, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.6.2005.

7. Pronarët, e përcaktuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët në kolonën “Shënime”, nga zyra e regjistrimit, është shkruar “Mungesë kartepronësie” apo “Proces regjistrimi”, të marrin shpërblimin, për efekt të shpronësimit, pasi të jenë pajisur me dokumentacionin e plotë ligjor nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Deri në atë çast paratë do të jenë të bllokuara në bankë.

8. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE

Lista e Pronareve qe shproneshohen per efekt te ndertimit te segmentit rrugor Orikum Dhermi.
Dukat Fshat, Bashkia Orikum

Lloji i Pasurise se paluajtshme: Toke bujqesore dhe dru frutor nr.(1-23).

Nr	Emri	Alesia	Miemri	Nr.pasu.	Toke bujqesore			Dru frutore			Shenime
					Superfaqe m2	Cnimi l/m2	Vlera leke	ad O	Vlera leke	Totali leke	
1	Pandeli	Koco	Qesargjoni	268/2,270/2	521	600	312600	78	135000	447600	Proces rregjistrimi
2	Koco	Pavlo	Qesargjoni	268/1,270/1	1248	600	748800	10	93000	841800	Proces rregjistrimi
3	Thoma	Visevo	Koncomi	52/2	96	600	57600			57600	Proces rregjistrimi
4	Simo	Nasi	Kazheli	248/12,13	1210	600	726000	247	131000	857000	Proces rregjistrimi
5	Prenjo	Ismail	Halliti	248/11	570	600	342000			342000	Proces rregjistrimi
6	Thanas	Murat	Kapo	239/12	700	600	420000	10	5000	425000	Proces rregjistrimi
7	Brahim	Thanas	Kapo	248/5	210	600	126000			126000	pretendon Thanas Murat Kapo
8	Pellumb	Thanas	Kapo	248/4	200	600	120000	10	5000	125000	pretendon Thanas Murat Kapo
9	Yzeir	Murat	Kapo	239/11	675	600	405000	15	60000	465000	Proces rregjistrimi
10	Ismail	Asllan	Hundo	248	130	600	78000			78000	Proces rregjistrimi
11	Sulo	Zequir	Hundo	248	1075	600	645000			645000	Proces rregjistrimi
12	Sulo	Zequir	Hundo	242	125	600	75000			75000	Proces rregjistrimi
13	Sulo	Zequir	Hundo	141/4	125	600	75000	10	94000	169000	Proces rregjistrimi
14	Israil	Asllan	Hundo	242	850	600	510000			510000	Proces rregjistrimi
15	Yzeir		Bodo	248	185	600	111000			111000	Proces rregjistrimi
16	Zihni	Tafil	Vangjeli	226	307	600	184200			184200	Proces rregjistrimi
17	Qendro	Sulejman	Kashuri	252	65	600	39000			39000	Proces rregjistrimi
18	Hasan	Sabri	Xhelili	252	85	600	51000			51000	Proces rregjistrimi
19	Yzeir	Murat	Kapo	252	40	600	24000			24000	Proces rregjistrimi
20	Krenar	Hysni	Kapo	252	40	600	24000			24000	pretendon Hysni Murat Kapo
21	Vasil	Nase	Kazheli	240	117	600	70200			70200	Proces rregjistrimi
22	Nase	Pulo	Kazheli	240	40	600	24000			24000	Proces rregjistrimi
23	Lefter	Pavlo	Leka	204	300	600	180000	5	5000	185000	Proces rregjistrimi
Shuma 1					8914	600	5348400	385	528000	5876400	

Lista e Pronareve qe shpronesohen per efekt te ndertimit te segmentit rrugor Orikum Dhermi.
Dukat Fushe, Bashkia Orikum

Lloji i Pasurise se paluatishme: Toke bujqesore dhe dru frutor nr.(1-66).

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr. pasu.	Toke bujqesore			Dru frutore			Shenime
					Siperfaqe m ²	Cmimi l/m ²	Vlera leke	ad	Vlera leke	Totali leke	
1	Qemal	Sinan	Mehilli	352/4	248	600	148800	6	49500	198300	Konfirmim nga Bashkia Orikum
2	Aliko	Sinan	Mehilli	352/3	212	600	127200	4	33200	160400	Konfirmim nga Bashkia Orikum
3	Izet	Sinan	Mehilli	352/2	120	600	72000	4	33200	105200	Konfirmim nga Bashkia Orikum
4	Fatosh	Sinan	Mehilli	352/1	160	600	96000	6	49800	145800	Konfirmim nga Bashkia Orikum
5	i paidentifikuar			353/4	192	600	115200			115200	shenimi nr. 1
6	i paidentifikuar			359/9,8	720	600	432000	20	10000	442000	pretendon Imet Muko
7	i paidentifikuar			359/4	600	600	360000			360000	pretendon Serri Ismail Kuteli
8	Serri	Ismail	Kuteli	358	520	600	312000			312000	Konfirmim nga Z Rr P P
9	Mele	Ismail	Kuteli	358	420	600	252000			252000	Konfirmim nga Z Rr P P
10	Fejzi	Ismail	Kuteli	358	544	600	326400			326400	Konfirmim nga Z Rr P P
11	Zgjidhje Pronesie			3, 6	260	600	156000			156000	Konfirmim nga Z Rr P P
12	Fejzi	Ismail	Kuteli	307/1	428	600	256800			256800	Konfirmim nga Bashkia Orikum
13	Zenel	Bejo	Bedini	307/2	240	600	144000	15	12500	156500	Konfirmim nga Z Rr P P
14	Xhebro	Bejo	Bedini	307/3	240	600	144000			144000	Konfirmim nga Z Rr P P
15	Tajar	Aydul	Kuteli	307/4	520	600	312000			312000	Konfirmim nga Z Rr P P
16	Riza	Haxhi	Kuteli	301/3	180	600	108000			108000	Konfirmim nga Z Rr P P
17	Firjat	Ahmet	Mehilli	280/3	120	600	72000			72000	Konfirmim nga Z Rr P P
18	Mehmet	Hysen	Mehilli	280/4	120	600	72000			72000	Konfirmim nga Z Rr P P
19	Qani	Ahmet	Mehilli	280/2	120	600	72000			72000	Konfirmim nga Z Rr P P
20	Bejko	Sinan	Mehilli	280/1	120	600	72000			72000	Konfirmim nga Z Rr P P
21	Vexhi	Muharrem	Nelo	280/5	372	600	223200	15	120000	343200	Konfirmim nga Z Rr P P
22	Qazim	Muharrem	Nelo	280/8	160	600	96000	15	85500	181500	Konfirmim nga Z Rr P P
23	Ymer		Koshena	280/12	280	600	168000	23	66000	234000	Konfirmim nga Z Rr P P
24	Mihal	Thanas	Dhima	280/17	752	600	451200	17	73000	524200	Plotesim dokumentacioni
25	Sadik	Selman	Cipa	280/18	520	600	312000			312000	Plotesim dokumentacioni
26	Ahmet Gllava			211/3, 4	1080	600	648000			648000	Plotesim dokumentacioni
27	Bashkim Hoxha			211/2	580	600	348000	16	81000	429000	pretendon Shyqyri Hoxha
28	Sinan	Isuf	Fisti	211/3	440	600	264000	21	45300	309300	Konfirmim nga Bashkia Orikum

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE

Lista e Pronareve qe shpronsohen per efekt te nderimit te segmentit rrugor Orikum Dhermi.
Dukat Fushe, Bashkia Orikum

Lloji i Pasurise se palatjeshme: Toke bujqesore dhe dru frutor nr.(1-66).

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr.pas.	Toke bujqesore			Dru frutore		Shenime
					Siperfaqe m2	Cmimi l/m2	Vlera leke	Capo	Vlera leke	
29	Mustafa	i Paidentifikuar	Selami	211	580	600	348000		348000	Plotesim dokumentacioni
30	Xhevdet	Selam	Selami	195/5	20	600	12000		12000	Plotesim dokumentacioni
31	Mustafa	Selam	Selami	195/6	40	600	24000		24000	Plotesim dokumentacioni
32	Xhevdet	Selam	Selami	192	32	600	19200		19200	Plotesim dokumentacioni
33	Xhevdet	Selam	Selami	180	35	600	21000		21000	Plotesim dokumentacioni
34	Xhezo	Selam	Selami	195/4	8	600	4800		4800	Plotesim dokumentacioni
35	Muharrem	Ali	Jazo	192/4	40	600	24000		24000	Konfirmim nga Z Rr P.P
36	Fetah	Serri	Jazo	194/2	111	600	66600		66600	Plotesim dokumentacioni
37	Hamdi	Memishta	Jazo	185/8	240	600	144000		144000	shenimi nr.2
38	Salo	Serri	Jazo	72	120	600	72000		72000	
39	Zace	Sinan	Capo	72	120	600	72000		72000	Plotesim dokumentacioni
40	Sabri	Idai	Capo	72	432	600	259200		259200	Plotesim dokumentacioni
41	Hasan	Jaup	Capo	72	177	600	106200		106200	pretendon Agim Enver Kondi
42	Qendro	Jaup	Capo	72	270	600	162000		162000	Plotesim dokumentacioni
43	Sabri	Sinan	Capo	72	228	600	136800		136800	Plotesim dokumentacioni
44	Tomorri	Gani	Capo	72	99	600	59400		59400	Plotesim dokumentacioni
45	Xhevdet	Xhafer	Capo	72	189	600	113400		113400	Plotesim dokumentacioni
46	Elmaz	Xhafer	Capo	72	105	600	63000		63000	Plotesim dokumentacioni
47	Trashigim.	Kazheli	Capo	65	105	600	63000		63000	Plotesim dokumentacioni
48	Fasli	Kastriot	Alushi	62/2	220	600	132000		132000	Konfirmim nga Bashkia Orikum
49	Isuf	Sali	Alushi	62/7	295	600	177000		177000	Plotesim dokumentacioni
50	Kastriot	Sadedin	Alushi	62	75	600	45000	19	29900	Plotesim dokumentacioni
51	Nebi	Ejup	Alushi	62/1	63	600	37800		37800	Plotesim dokumentacioni
52	Reiz	Kamber	Alushi	62	75	600	45000		45000	Plotesim dokumentacioni
53	Ejup	Sadedin	Alushi	62	96	600	57600		57600	Plotesim dokumentacioni
54	Najo	Murat	Alushi	64/11	100	600	60000		60000	Plotesim dokumentacioni
55	Liri		Alushi	64/10	80	600	48000		48000	Plotesim dokumentacioni
56					40	600	24000		24000	Plotesim dokumentacioni

Lista e Pronareve qe shpronesohen per efekt te nderimitit te segmentit rrugor Orikum Dhermi.
Dukat Fushe, Bashkia Orikum

Lloji i Pasurise se paluatishme: Toke bujqesore dhe dru frutor nr.(1-66).

Nr	Emri	Atesia	Mblemri	Nr. pasu.	Toke bujqesore		Dru frutore		Shenime
					Siperfaqe m2	Cmimi /m2	Vlera leke	Vlera leke	
57	Gjergji	Kastriot	Alushi	64/9	40	600	24000		Plotesim dokumentacioni
58	Bendo	Sadik	Gjikoka	64/2	40	600	24000		Plotesim dokumentacioni
59	Bilbil	Bendo	Gjikoka	64/1	70	600	42000	5	Plotesim dokumentacioni
60	Asllan	Sadik	Gjikoka	64/4	160	600	96000		Plotesim dokumentacioni
61	Koke	Asllan	Gjikoka	62/3	160	600	96000		Plotesim dokumentacioni
62	Zeqir	Halim	Habili	48	410	600	246000		Konfirmim nga Bashkia Orikum
63	Hito	Tahir	Merkohito	48/10	58	600	34800		Plotesim dokumentacioni
64	Piko	Hito	Merkohito	48/7	58	600	34800		Plotesim dokumentacioni
65	Lace	Elmaz	Merkohito	48/3	58	600	34800		pretendon Tahir Elmaz Merkohito
66	Vitri	Piko	Merkohito	48/8	58	600	34800		pretendon Hyrjet Merkohito
		Shuma 2			15495	600	9297000	186	
		Shuma 1			8914	600	5348400	385	
		Totali 1+2			24409		14645400	571	15883300

Shenimi nr. 1 ; per nr. rendor 5 " i Paindetifikuar " pretendojne Firjat Ahmet Mehilli, Mehmet Hysen Mehilli, Qani Ahmet Mehilli dhe Bejko Sinan Mehilli.

Shenimi nr. 2; per nr. rendor 37 me pronare Hamdi Jazo , pretendojne Sinan Jazo per sip. 135 m2 dhe Dervish Jazo per sip. 105 m2.

Shpenzime procedurale leke 686 520
Vlera totale e shpronesimit leke 16 569 820

VENDIM
Nr.388, datë 31.5.2005

PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN, TË DREJTAT DHE DETYRAT E KOMISIONIT
SHTETËROR TË PRODHIMIT ORGANIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.9199, datë 26.2.2004 “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve “Bio”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni Shtetëror i Prodhimit Organik (KSHPO), i cili krijohet si organ ndërinstitutional, të ketë në përbërje 9 veta, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|----------|
| - Zëvendësministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit | kryetar; |
| - Drejtori i Drejtorisë së Prodhimit Blegtoral, në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit | anëtar; |
| - Drejtori i Drejtorisë së Prodhimit Bimor dhe Mbrojtjes së Bimëve, në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit | anëtar; |
| - Përgjegjësi i sektorit të Drejtorisë së Cilësisë dhe Inspektimit të Ushqimeve, në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit | anëtar; |
| - Juristi i Drejtorisë Juridike dhe Përshtatjes së Legjislacionit, në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit | anëtar; |
| - Drejtori i Drejtorisë së Shëndetit Parësor, në Ministrinë e Shëndetësisë | anëtar; |
| - Një përfaqësues nga Shoqata e Bujqësisë Organike | anëtar; |
| - Një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit | anëtar; |
| - Një përfaqësues nga Universiteti Bujqësor i Tiranës | anëtar. |

2. KSHPO-ja thirret në mbledhje një herë në muaj, me njoftim të kryetarit. Për raste të veçanta, kur vlerësohet nga kryetari, KSHPO-ja mund të mbledhet në çdo kohë.

3. Vendimet në KSHPO merren kur janë të pranishëm mbi 50 për qind e anëtarëve. Kur nga votimi rezultojnë vota të barabarta, vota e kryetarit është përcaktuese.

4. KSHPO-ja, në mbledhjen e parë, zgjedh sekretarin, i cili ndjek dhe drejton punën e sekretariatit të këtij komisioni.

5. Sekretariati përbëhet nga tre anëtarë, përkatësisht, një specialist nga Drejtoria e Prodhimit Bimor dhe e Mbrojtjes së Bimëve, një nga Drejtoria e Prodhimit Blegtoral dhe një nga Drejtoria e Cilësisë dhe Inspektimit të Ushqimeve. Sekretariati përgatit dokumentet dhe materialet për mbledhjen e KSHPO-së, administron dokumentet dhe aktet, që miratohen në KSHPO, si dhe nxjerr buletinin e këtij Komisioni. Mënyra e funksionimit të sekretariatit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Anëtarët e KSHPO-së, për pjesëmarrjen në mbledhjet e këtij Komisioni, të shpërblehen me 6000 (gjashtë mijë) lekë në muaj, ndërsa kryetari dhe sekretari me nga 8000 (tetë mijë) lekë. Shpenzimet për shpërblimet e anëtarëve të mbulohen nga buxhetet vjetore të institucioneve përkatëse.

7. Administrimi i të ardhurave, që krijohen nga veprimtaria e KSHPO-së, bëhet sipas vendimit nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”.

8. Detyrat dhe të drejtat e KSHPO-së janë:

a) Pranon dhe analizon praktikat e organizmave certifikues dhe të trupave inspektues, vendas ose të huaj, me të cilët lidh kontratë bashkëpunimi.

b) Regjistron organizmat certifikues dhe trupat inspektues, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

c) Regjistron kërkesat e fermerëve, që pranojnë të punojnë si njësi të prodhimit organik, dhe ia përcjell për zbatim organizmit certifikues, të për zgjedhur nga vetë fermerët aplikues.

ç) Miraton planet vjetore të veprimtarisë së organizmave certifikues, vendas ose të huaj.

d) Regjistron/çregjistron nga regjistri kombëtar i njësive të prodhimit organik, pas miratimit nga organizmi certifikues, njësitë e prodhimit, të përpunimit dhe të tregtimit të produkteve “Bio”. Çdo njësi e prodhimit organik ka një numër të veçantë identifikimi. Të dhënat e këtij regjistrimi janë konfidenciale dhe mund të përdoren vetëm nga KSHPO-ja dhe organizmi certifikues.

dh) Bën publike listën e përditësuar të emrave dhe adresave të njësive të prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve “Bio”, subjekte të inspektimit.

e) Regjistron subjektet vendase ose të huaja, që eksportojnë a importojnë produkte “Bio”.

ë) Vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga subjektet, që eksportojnë apo importojnë produkte “Bio”, për metodën e përdorur në prodhimin e produkteve të tyre dhe i pajis këto subjekte me certifikatë eksport-importi. Certifikata e lëshuar është e vlefshme vetëm për rastin e shqyrtuar.

f) Propozon tarifat e pagesave për regjistrimin e organizmave certifikues dhe të trupave inspektues, vendas ose të huaj, si dhe të njësive të prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve “Bio”. Këto tarifa miratohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

g) Kontrollon, sipas kontratës së bashkëpunimit, veprimtarinë e organizmave certifikues, të miratuar, dhe të trupave inspektues, vendas ose të huaj nëse është në përputhje me ligjin nr.9199, datë 26.2.2004 “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve “Bio”, si dhe me aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

Nëse vëren se veprimtaria e tyre nuk është në përputhje me ligjin dhe aktet e tjera nënligjore, vendos ndërprerjen e kontratës së bashkëpunimit.

gj) Publikon logon e organizmit certifikues.

h) I paraqet për miratim Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit vendimet e marra për pranimin e veprimtarisë ose ndërprerjen e kontratës së bashkëpunimit për organizmat certifikues dhe trupat inspektues, vendas ose të huaj. Vendimi i miratuar botohet në buletin e KSHPO-së.

i) Njofton me shkrim subjektet e interesuara për shkaqet e mospranimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e tyre në KSHPO.

j) Propozon modelet e formularëve, që duhen plotësuar nga njësitë e prodhimit organik, organizmat certifikues dhe subjektet importuese-eksportuese, si dhe të certifikatës së eksport-importit të produkteve “Bio”, të cilat miratohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

k) Organizon kualifikimin e inspektorëve të prodhimit organik, sipas një programi të miratuar, për një periudhë jo më pak se pesë ditë në vit. Shpenzimet për kualifikimin e inspektorëve mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe i Ushqimit, i caktuar për shërbimin këshillimor, si dhe nga projekte, organizma certifikues dhe donatorë.

l) Pajis inspektorët me kartën e inspektorit të prodhimit organik dhe vë në dijeni organizmat certifikues.

ll) Organizon kontrollin e njësive të prodhimit, të grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve “Bio” me inspektorët e miratuar të prodhimit organik.

9. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.419, datë 9.6.2005

**PËR DISA NDRYSHIME NË DOKUMENTIN “RREGULLORJA E SHËRBIMIT TË
JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.839,
DATË 17.12.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 49 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 92 të dokumentit “Rregullorja e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.839, datë 17.12.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

- a) Shkronja “b” e pikës 5, ndryshohet si më poshtë vijon:
“b) që ka jo më pak se 7,5 vjet punë, drejtpërdrejt në shërbimin e jashtëm.”.
- b) Shkronja “b” e pikës 6, ndryshohet si më poshtë vijon:
“b) që ka jo më pak se 10 vjet punë, drejtpërdrejt, në shërbimin e jashtëm.”.
- c) Nën-pika 7.1 e pikës 7, ndryshohet si më poshtë vijon:
“7.1 që ka jo më pak se 21 vjet vjetërsi të integruar në punë, nga të cilat jo më pak se 13 vjet, drejtpërdrejt në shërbimin e jashtëm.”.

2. Ngarkohet Ministri i Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

**UDHËZIM
Nr.17, datë 6.6.2005**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR DEKLARIMIN E SHPENZIMEVE TË
FUSHATËS ZGJEDHORE, TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PJESËMARRËSE NË
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË VITIT 2005**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 6.6.2005, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtare
Pandeli Varfi	Anëtar
Çlirim Gjata	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar

Në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 144 dhe nenit 145/1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë procedurat për pranimin, regjistrimin, deklarimin dhe raportimin e dhuratave që marrin subjektet zgjedhore, nga personat fizikë dhe juridikë, privatë vendas

për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2005.

Neni 2

Partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje, kandidatët e tyre, si dhe koalicionet zgjedhore janë të detyruar të regjistrojnë dhe të deklarojnë sipas formularëve tip bashkëlidhur këtij udhëzimi çdo dhuratë apo përfitim për fushatën zgjedhore.

Neni 3

Partitë politike, kandidatët e tyre, kandidatët e pavarur, si dhe koalicionet mund të përfitojnë për fushatën e tyre zgjedhore dhurata nga persona fizikë ose juridikë, privatë vendas.

Neni 4

Kanë të drejtë të japin dhurata persona fizikë ose juridikë, privatë vendas, si dhe individë.

Neni 5

1. Dhuratat të cilat mund t'u jepen subjekteve zgjedhore ndahen në tre lloje:
 - Dhurata në vlerë monetare;
 - Dhurata në shërbime;
 - Dhurata në sende.
2. Asnjë dhurues nuk mund t'i japë të njëjtit subjekt zgjedhor dhurata në vlerë më të madhe se 1 milion lekë ose kundërvleftën në sende apo shërbime.

Neni 6

Subjekti zgjedhor, të cilit i ofrohen dhurata në vlera monetare, sende ose shërbime, sigurohet paraprakisht për identitetin e dhuruesit dhe pasi e pranon dhuratën e regjistron atë duke e përshkruar në mënyrë të saktë dhe të plotë.

Neni 7

Subjekti zgjedhor duhet të deklarojë çdo dhuratë të marrë në periudhën nga data e daljes së Dekretit të Presidentit deri në datën e zgjedhjeve, sipas formularit Model 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 8

Për çdo dhuratë në sende ose shërbime, subjekti zgjedhor do të llogarisë dhe deklarojë kundërvleftën në lekë të sendeve ose shërbimeve duke u bazuar në indeksin mujor të çmimeve, të publikuar nga INSTAT. Për sendet ose shërbimet, vlera e të cilave nuk pasqyrohet në indeksin mujor të çmimeve, partitë politike dhe kandidatët e pavarur do t'i referohen çmimit të tregut në momentin e marrjes së dhuratës.

Neni 9

Për secilën prej dhuratave, pas vlerës në lekë do të shënohet:

- a) Shkronja M (për dhuratat në mjete monetare);
- b) Shkronja S (për dhuratat në sende);
- c) Shkronja SH (për dhuratat në shërbime).

Neni 10

Subjekti zgjedhor do të regjistrojë dhe deklarojë në formularin Model 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, të gjitha shpenzimet që do të kryejë në periudhën nga data e daljes së Dekretit të Presidentit deri në datën e zgjedhjeve.

Neni 11

Partitë politike u kërkojnë kandidatëve të tyre për deputetë që t'u dërgojnë të plotësuar formularët Model 1 dhe 2, ku pasqyrohen të gjitha dhuratat dhe shpenzimet e kryera në periudhën nga data e daljes së Dekretit të Presidentit deri në datën e zgjedhjeve.

Neni 12

Partitë politike i përfshijnë këto të dhëna në formularët Model 1 dhe Model 2, ku ata kanë regjistruar dhe deklaruar dhuratat e përfituara prej tyre, dhe i dorëzojnë në KQZ jo më vonë se 45 ditë pas datës së zgjedhjeve.

Neni 13

Çdo faqe e formularëve Model 1 dhe 2, pas plotësimit do të vuloset dhe nënshkruhet prej kryetarit të partisë, ose sipas rastit, do të nënshkruhet prej kandidatit të pavarur.

Neni 14

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.




Model 1

TABELA E DHURATAVE TE PËRFITUARA NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR _____ PREJ PERSONAVE FIZIKË OSE JURIDIKË PRIVATË VENDAS, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË VITIT 2005

NR	PËRSHKRIMI I DHURIMIT	VLERA NE LEK	SUBJEKTI TË CILIT I ËSHTË BËRË DHURATA (NËSE ËSHTË I NDRYSHËM NGA PARTIA)	IDENTITETI I PLOTË I DHURUESIT	DATA E DHURIMIT	NR. I LLOGARISË KU U DEPOZITUA DHURATA
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
SHUMA TOTALE E DHURUAR						
Shifër (fjalë) lek						

SUBJEKTI ZGJEDHOR _____



UDHËZIM
Nr.18, datë 10.6.2005

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.5, DATË 5.4.2005 “PËR
DETYRAT E POLICISË SË SHETITIT DHE FORCAVE TË USHTRISË PËR ZGJEDHJET
PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË VITIT 2005”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 10.6.2005, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtare
Pandeli Varfi	Anëtar
Çlirim Gjata	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar

Në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe nenit 109/1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

“1. Gjatë procesit të numërimit të votave, kur KZZ-ja konstaton se në ambientin e VNV-së janë të pranishëm dhe persona të tjerë, përveç atyre të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 109/8, u kërkon atyre që të largohen. Në rast refuzimi, merr vendim për njoftimin e punonjësit të Policisë së Shtetit dhe mban shënim në librin e protokollit.

2. Kur në vendin e numërimit të votave rrezikohet rendi, KZZ-ja me vendim thërret organet e Policisë së Shtetit.

3. Vendimi për kërkimin e ndihmës së vendosjes së rendit i paraqitet me shkrim organeve të Policisë së Shtetit dhe përmban përshkrimin e shkurtër të shkaqeve dhe të rrethanave.

4. Me marrjen e vendimit, Kryetari, zëvendëskryetari ose çdo anëtar i KZZ-së thërret menjëherë policinë dhe njofton KQZ-në për incidentin e ndodhur.

5. Sapo forcat e policisë paraqiten në vendin e numërimit të votave, vendimi për të ndërhyrë u dorëzoht atyre menjëherë.

6. Me rivendosjen e rendit në vendin e numërimit të votave, KZZ-ja me vendim u kërkon forcave të Policisë së Shtetit të largohen.

7. Vendimi i KZZ-së për ndërhyrje merret sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi.”

Neni 2

Pika 3 e nenit 10 ndryshon si më poshtë:

“Shoqërimi i kutive të votimit dhe i kutive me materialet e votimit nga KQV-ja në vendin e numërimit të votave bëhet me automjet në të cilin ndodhen anëtarët e KQV-së, sekretari i KQV-së dhe një punonjës i Policisë së Shtetit.”

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.



Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tiranë.
Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 62
Website: www.ccc.org.al
E-mail:
infosac@ccc.org.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE MODEL-V
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR. _____

VENDIM

Nr. _____, datë _____.07.2005

PËR NJOFTIMIN E POLICISË SË SHETIT

Komisioni i Zonës Zgjedhore Nr. _____, sot në orën _____, meqenëse në ambjentin e VNV-së ndodhen persona të paautorizuar dhe/ose rrezikohet rendi, bazuar në nenin 109/8, pika 2, të "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar si dhe Udhëzimin nr.18, datë 10.06.2005 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.5 datë 05.04.2005 "Për miratimin e detyrave të Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të viti 2005",


VENDOSI:

1. Të njoftojë sot në datën _____.07.2005 ora _____ forcat e Policisë së Shtetit për nxjerrjen e personave të paautorizuar dhe/ose rivendosjen e rendit në Vendin e Numërimit të Votave.
2. Ky vendim t'i njoftohet menjëherë KQZ-së.


Komisioni i Zonës Zgjedhore Nr. _____

		Pro/kundër	Firma
1.	_____ Kryetar	_____	_____
2.	_____ Zv/kryetar	_____	_____
3.	_____ Anëtar	_____	_____
4.	_____ Anëtar	_____	_____
5.	_____ Anëtar	_____	_____
6.	_____ Anëtar	_____	_____
7.	_____ Anëtar	_____	_____

VULA



Model i miratuar me Udhëzimin e KQZ-së Nr. 18, datë 10.06.2005



This image shows a single page of white paper with horizontal blue or grey ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are approximately 20 lines visible. The paper appears to be from a notebook or a standard writing template. There is no handwriting or other markings on the page.



1488

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdolloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 13.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë